



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.269/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.2995/19 i datës 16.03.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çeshtje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.654/2019 të datës 24.10.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër Njoftimin të datës 25.09.2019 për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit “Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve ne Prizren” të shpallur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.654/2019 e datës 24.10.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. MBETET në fuqi Njoftimi i datës 25.09.2019 për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit “Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren” të shpallur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bazë të autorizimit të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike të datës 19.07.2019, me datë 24.07.2019 ka shpallur konkursin për pozitën “Zyrtar për Pensione” në kuadër të Zyrës së Pensioneve në Prizren. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është ftuar të marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit (testin me shkrim dhe me gojë). Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale procedurën e rekrutimit testin me shkrim dhe me gojë e ka përfunduar gjatë kohës sa ka qenë në fuqi Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa vetëm njoftimin për kandidatin e suksesshëm është publikuar pasi që ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më datë 25.09.2019 ka publikuar njoftimin për rezultatin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit për procedurën e rekrutimit "Zyrtar për Pensione në Zyrën e Pensioneve në Prizren" në bazë të të cilit ankuesja nuk është kandidatë e suksesshme.

Ankuesi kundër këtij njoftimi më datë 30.09.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit duke njoftuar që të parashtroj ankesë drejtpërdrejt në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.10.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5011/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më datë 31.10.2019 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 18.11.2019 përmes shkresës me numër të protokollit 5424/2019, ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 24.10.2019, duke udhëzuar te njëjtën që ti ndjekë më tutje procedurat ligjore. Ankuesja ka parashtruar padi me datë 13.12.2019 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 16.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr.2995/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses ka anuluar Njoftimin e KPMSHCK -së të datës 18.11.2019 dhe detyron të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e paditëses të datës 24.10.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankuesën me numër protokollit 5011/2019 të datës 24.10.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankuesën e datës 30.09.2019 e parashtruar nga ankuesja për Komisionin e Ankesave të MPMS-së; Njoftimi i datës 21.10.2019; Njoftimin e datës 25.09.2019 për rezultatin përfundimtar për procedurën e rekrutimit; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 07.09.2016; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 30.01.2016; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 01.02.2016; Marrëveshje për angazhim në masë aktive të tregut të punës-praktikë në punë e datës 28.02.2019; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 04.06.2016; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 06.10.2017; Marrëveshje për praktikë në punë e datës 31.01.2016; Diploma e datës 02.02.2015 e lëshuar nga kolegji Fama;



Certifikata e notave e datës 29.07.2019 e lëshuar nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren; Certifikatë e datës 26.03.2019; Certifikatë e vitit 2009; Certifikatë e vitit 2011; Letër reference e datës 21.03.2013; Referencë e datës 12.01.2009; Njoftim i datës 25.09.2019; Kërkesë për aprovim e datës 19.09.2019; Konkursin e datës 24.07.2019 për pozitën "Zyrtar për pensione" të shpallur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 19.07.2019; Vendimin i data 09.08.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Formularin Form.MAP-SHCK-04 për regjistrin e aplikacioneve të pranuar; Formularin e listës së kandidatëve; Kërkesën për aprovim e datës 19.09.2019; Formularin Form.MAP-SHCK-11 për raportin final me rekomandim nga komisioni rekrutues i datës 06.09.2019; Formularin Form.MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formularin Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale të kandidatëve; Formularin Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Formularin Form.MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim të datës 27.08.2019; Kërkesën për punësim të kandidatës Diplomën për Pranvera Dakaj e datës 25.09.2018, Certifikatat e Vërtetimin e datës 05.08.2019; Referencë pune nga Ndërmarrja ÇLIRIMI; Kërkes për punësim e datës 07.08.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara dhe Përgjigjen në ankesë e datës 31.10.2019 me numër protokollit 5106/2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkrimet e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon që kandidatja mbi 45 minuta është vonuar në testimin me gojë dhe komisioni e ka pritur; E njëjta nuk ka plotësuar kushtet minimale të konkursit pasi që nuk ka përvojë punës asnjë ditë duke mos qenë të barabartë në këtë procedurë; E njëjta është anëtare e NISMA-së në Prizren dhe kandidatë për asamble komunale në Prizren për zgjedhje lokale të vitin 2017 dhe tash është përzgjedhur si kandidatë e suksesshme që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shkak të konfliktit të interesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që kandidatja mbi 45 minuta është vonuar në testimin me gojë dhe komisioni e ka pritur, ka konstatuar që kandidatja më datë 03.09.2019 nëpërmjet deklaratës ka deklaruar se: "...gabimisht jam informuar për vendin e intervistimit, më datë 03.09.2019 në orën 10:10 jam paraqitur në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për intervistë me gojë nga ku mësova se vendi i intervistimit është në Prizren. Për shkak se i-ja duke udhëtuar me autobus, kam lënë në pritje më shumë se 1 orë e 30 minuta pjesëtarët e komisionit", po ashtu për të sqaruar këtë situatë më datë 01.11.2019 nëpërmjet e-mailit kemi kërkuar nga sqarim si ne vijim: "kërkojnë nga ju të na njoftoni se në cilin vend është mbajtur testi me shkrim dhe me gojë për kandidatët dhe në çfarë forme është njoftuar për testim me shkrim dhe me gojë kandidatja e përzgjedhur", ndërsa më datë 01.11.2019 nëpërmjet e-mailit nga jemi njoftuar se: "Komisioni Përzgjedhës i shërbimit civil, testimin me shkrim dhe me gojë të kandidatëve e ka mbajtur në lokalet e Zyrës së Pensioneve në Prizren për pozitën Zyrtar të Pensioneve, në të dy testimet të gjithë

kandidatët janë njoftuar me kohë përmes telefonit”, si rrjedhojë edhe kandidatja

pranuar që është vonuar në intervistën me gojë që është mbajtur më datë 03.09.2019, por vonesa e saj ka qenë për faktin që e njëjta ka keqkuptuar vendin e mbajtjes së testit me gojë, kështu që ardhja në Prishtinë në zyrat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka tumbuar një kohë derisa ka kuptuar që intervista do të mbahet në Zyrat e Punësimit në Prizren, por rast e njëjta ka udhëtuar për në Prizren, kështu kjo vonës nuk ka ndikuar asgjë në rezultatin përfundimtar pasi që gjatë procesit nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale, andaj Kolegji konstaton se testi me gojë është mbajtur në pajtim me nenin 38 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankueses se komisioni përzgjedhës nuk i ka bërë vlerësimin real të përvojës së punës në krahasim me kandidatet e përzgjedhur, ky pretendim nuk është i qëndrueshëm sepse kandidatja e përzgjedhur ka përvojë të punës të kërkuar në pajtim me kriteret e konkursit të datës datë 24.07.2019 siç është kërkuar, *“Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi dhe Shkenca Sociale pa përvojë pune ose shkollë e Latë me dy (2) vjet përvojë punë në fushën administrative dhe teknike”*, sepse ka kandidatja e përzgjedhur posedon Diplomë me Nr.525/0918 të datës 25.09.2018 me të cilën dëshmohet se më datës 16.07.2018 ka mbaruar studimet themelore në Kolegjin FAMA duke marr titullin *“Bachelori i Arteve në Psikologji”* dhe meqenëse në konkurs është përcaktuar që kandidatët që kanë diplomë universitare nuk ka qenë kusht të kenë përvojë të punës ndërsa përvoja e punës ka qenë kusht vetëm për kandidatët që kanë përfunduar shkollën e lartë, në këtë rast kandidatja e përzgjedhur ka plotësuar të gjitha kushtet e konkursit po ashtu edhe ankuesja ka plotësuar të gjitha kushtet e konkursit, me çka nënkuptohet se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil me rastin e përfshirjes së tyre në listën e shkurtër ka vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: arsimimin dhe kualifikimin profesional dhe përvojën e punës”*, po ashtu në bazë të provave të lëndës, konstatohet që në konkursin për pozitën *“Zyrtar për Pensione”*, i është dhënë mundësia e barabartë të gjithë kandidatëve të cilët kanë aplikuar duke u respektuar neni 3 paragrafi 9 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe neni 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, po ashtu në fund të konkursit është përcaktuar që *“Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovës”*, ndërsa edhe vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi respektivisht nenin 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila ka pretenduar se kandidatja e përzgjedhur sipas legjislacionit në fuqi ka konflikt interesi sepse është aktive në politike gjegjësisht është anëtare e Partisë Politike „NISMA” në Prizren dhe ka qenë ish kandidatë për Deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga kjo parti, andaj mbi baze të kësaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka konstatuar se ky pretendim nuk hynë në fushën e përgjegjësive dhe fushëveprimit të tij dhe se

për raste të tilla duhet të ketë një vendim me shkrim nga organet kompetente të cilat bëjnë interpretimin e konflikt interesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se në bazë të Formularit të Renditjes Përfundimtare të Kandidatëve, kandidatja e përzgjedhur pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me 733.5 pikë, ndërsa ankuesja është renditur e pesta me 614 pikë, mbi këtë bazë në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numrin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paaanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.269/2022, 15.04.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Malsore Gashi Bajraktari
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

